



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E METROLOGJISË
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE

Nr. 493 Prot.

Tiranë, më 19.02 2026

Lënda: Raporti i monitorimit të buxhetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë, viti 2025.

MINISTRISË SË EKONOMISË DHE INOVACIONIT
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME EKONOMIKE DHE SHËRBIMEVE
MBËSHTETËSE

DREJTORSË SË BUXHETIT DHE MENAXHIMIT FINANCIAR

Adresa: Bulevardi “Dëshmorët e 4 Shkurtit”, Tiranë

Në zbatim të ligjit nr. 115/2024, datë 03.12.2024 “Për buxhetin e vitit 2025”, të Udhëzimit Plotësues nr.2 datë 24.01.2025, “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025”, të Udhëzimit nr. 14, datë 30.05.2023 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Qëndrore”, Drejtorisë të Përgjithshme të Metrologjisë i është akorduar fond i planifikuar në vlerën **182 621 milion lekë** i detajuar si më poshtë:

Plani buxhetor i rishikuar i vitit 2025

Nr.	Emërtimi	Në 000/lekë
1	Fondi i Pagave:	108 225
2	Fondi i Sigurimeve Shoqërore:	18 222
3	Fondi për Shpenzime Operative:	34 200
4	Trasferta korente të huaja:	3 500
5	Trasferta për Buxh.Fam.Individ:	314
6	Kapitale të trupëzuara:	8 160
7	Shpenzime të tjera jashtë limitit	10 000

Nga fondi i përgjithshëm buxhetor, për periudhën e raportuar (viti 2025), shpenzimet e realizuara, sipas artikujve dhe emërtimeve përkatëse, paraqiten si më poshtë:

Fondi i pagave dhe sigurimeve shoqërore (llog. 600-601)

Nga fondi i planifikuar për pagat e punonjësve, në vlerën 108 225 mijë lekë, janë realizuar shpenzime në masën 108 225 mijë lekë ose 100 % e fondit total.

Ndërsa nga fondi i planifikuar për sigurimet shoqërore, në vlerën 18 222 mijë lekë, janë shpenzuar 18 124 mijë lekë, që përfaqësojnë 99.4 % të fondit të miratuar.

Fondi për shpenzime në zërin operative (llog 602), viti 2025

Fondi është realizuar në masën 33 289 mijë lekë, ose 97.3 % të planit vjetor.

Në realizimin e shpenzimeve operative, Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit (DPM) është mbështetur në një shpërndarje racionale të kërkesave, të cilat lidhen kryesisht me shpenzimet e detyrueshme utilitare, si: energjia elektrike, uji, shërbimet postare dhe telefonike, taksat për automjetet, me qëllim sigurimin e funksionimit normal të veprimtarisë institucionale.

Gjatë vitit 2025, janë realizuar disa procedura prokurimi për mallra dhe shërbime në funksion të nevojave funksionale, përfshirë:

- materiale pastrimi;
- siguracion për zyrat qendrore dhe automjetet;
- shërbim interneti;
- mirëmbajtje e faqes zyrtare të internetit;
- blerje dokumentacioni specifik;
- bileta avioni;
- blerje tretësirë referuese;
- mirëmbajtje e rrjetit elektrik;
- shpenzime për printim;
- paisja me shërbimin GPS të automjeteve;
- mirëmbajtje e paisjeve të kondicionimit;
- mirëmbajtje e objekteve ndërtimore, etj;

Për udhëtime pune jashtë vendit, janë shpenzuar 1 552 mijë lekë. Një pjesë e takimeve të planifikuara janë zhvilluar pa kosto, përmes pjesëmarrjes në platforma online.

Udhëtimet brenda vendit janë realizuar në shumën 3 428 mijë lekë.

Është lidhur dhe zbatuar kontrata për shërbimin e transportit të punonjësve, në vlerën 2 380 mijë lekë.

Gjithashtu, është lidhur kontrata për mirëmbajtjen e automjeteve, me vlerë totale 3 305 mijë lekë, e cila për vitin 2025 është realizuar shuma 3 304 mijë lekë, ose 100 % e saj.

Trasferta korente të huaja (Ilog.605)

Për pesë kuotat e anëtarësisë ku bën pjesë drejtorja, vlera e planifikuar për këtë grup është 3 500 mijë lekë dhe janë likuiduar të pesta në vlerë totale 3 405 mijë lekë

Trasferta për buxhetet familiare dhe individët (Ilog.606)

Nga fondi i planifikuar prej 314.000 lekë, janë realizuar shpenzime në vlerën 298 000 lekë, në zbatim të VKM nr. 929, datë 17.11.2010 “Për Krijimin dhe Përdorimin e Fondit të Veçantë”, e ndryshuar, që përfaqësojnë 95 % të totalit të parashikuar. Brenda kësaj shume janë përfshirë:

- 2 raste ndihme ekonomike për dalje në pension pleqërie
- 3 raste ndihme për fatkeqësi
- 1 rast ndihme për shkak të sëmundjes
- Kompensimi i shpenzimeve për telefoninë celulare të titullarit, në vlerën e përcaktuar në VKM nr. 673, datë 02.09.2020, “Për pajisjen me numër telefoni celular të funksionarëve publikë”.

Shpenzime të tjera jashtë limitit

Në këtë grup përfshihen shpenzimet e planifikuara sipas VKM nr. 571, datë 29.08.2012, “Për lejimin e përdorimit të të ardhurave të realizuara nga Drejtorja e Përgjithshme e Metrologjisë gjatë shërbimeve metrologjike dhe njohjen ndërkombëtare të etaloneve kombëtare të matjeve”. Shpenzimet përfshijnë kalibrimin e pajisjeve, shpenzimet për ruajtjen e godinës me shërbim sigurie, si dhe një pjesë të shpenzimeve për energjinë elektrike dhe karburantin.

Ky zë është realizuar në shumën 8 238 mijë lekë, ose 82.4% të fondit, dhe i përket pagesës në vlerën 4 385 mijë lekë për shërbimin e sigurimit të godinës, dhe pjesa tjetër 2 653 mijë lekë për kalibrimin e pajisjeve të laboratorëve të DMSHI. Procedura për këtë shërbim është prokuruar dhe ndarë në tre lote. Për dy lote nuk ka pasur operatorë të interesuar.

Për vitin 2025, Drejtorja e Përgjithshme e Metrologjisë (DPM) ka një strukturë të miratuar prej 98 pozicionesh. Me vendim të Këshillit të Ministrave, janë miratuar 6 punonjës me kontratë 6-orëshe.

Aktualisht, nga të gjitha pozicionet në strukturë, 40 mbulohen nga gra, përfshirë;

- Drejtoreshën e Përgjithshme
- Një drejtoreshë drejtorie
- Shtatë përgjegjëse sektori

Me fondet e vëna në dispozicion, DPM ka realizuar tre objektivat e përcaktuara për vitin 2025, të përfshira në Planin Buxhetor Afatmesëm (PBA) dhe planin vjetor të institucionit. Këto objektiva janë në përputhje me misionin e institucionit, i cili është:

“Mbrojtja e konsumatorëve dhe shtetit nga rezultatet e pasakta të matjeve; zhvillimi i sistemit kombëtar të metrologjisë në përputhje me kërkesat ndërkombëtare dhe nevojat kombëtare; njohja ndërkombëtare e rezultateve të matjeve dhe etaloneve kombëtare; lehtësimi i lëvizjes së lirë të instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara, nëse ato mbajnë shenjë e miratimit të tipit dhe verifikimit fillestar; si dhe lehtësimi i lëvizjes së lirë të produkteve të parapaketuara që kanë shenjë e konformitetit, përmes harmonizimit të metodave të matjes dhe kontrollit metrologjik.”

Gjatë vitit raportues janë realizuar gjithsej **44 772** verifikime dhe kalibrime, kundrejt **41 300** të planifikuara, duke përfaqësuar **108%** të planit të miratuar.

Nga kryerja e këtyre shërbimeve janë arkëtuar të ardhura në vlerën **74 704 mijë lekë**, kundrejt **72 000 mijë lekë** të planifikuara, ose **104%** e planit vjetor të mitatuar.

Aktualisht, sigurimi i gjurmueshmërisë është realizuar pjesërisht. Ky element është vendimtar për akreditimin e laboratorëve të DMSHI, i cili varet drejtpërdrejt nga përmbushja e këtij kriteri.

Për sa i përket investimit të planifikuar për “Blerje pajisje për testimin e radarëve të shpejtësisë dhe matjes se nivelit të zhurmave”, procedura u realizua e plotë.

Ndërkohë, është bërë aplikimi i procesit të akreditimit të Sektorëve të Shërbimit të DML pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Alkida Llaka

